



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. I faq Broj stranica No pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No.	06-1630/20
Data Datum	10.08.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 05.08.2020, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-1151/20*, për zyrtarin z. Behram Mazreku, Udhëheqës i Divizionit për Mallra Strategjike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Behram Mazreku, Udhëheqës i Divizionit për Mallra Strategjike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, pas pranimit të denoncimit nga jashtë, e ka hapur rastin e konfliktit të mundshëm të interesit, sipas të cilit zyrtari z. Mazreku, si Udhëheqës i Divizionit për Mallra Strategjike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, njëkohësisht ushtron edhe pozitën menaxherit në kompaninë private të derivateve "Eida Patroni".

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Mazreku, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit, dhe nga i njëjti është kërkuar që të paraqes një sqarim me shkrim në Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me pretendimet e ngritura për situatën e konfliktit të interesit.



Me qëllim të verifikimit të saktësisë për pretendimin e ngritur, Agjencia ka mbledhur informatat dhe dokumentacionet e nevojshme nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nga kompania private “Eida Patroni” si dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Në bazë të informatave të pranuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Departamenti i Burimeve Njerëzore, përmes shkresës zyrtare me nr. 2907 e datës 12.062020, jemi njoftuar për pozitën dhe detyrat që ai ushtron në MTI, si dhe faktin se Ministria nuk ka informacion zyrtar rreth angazhimit të zyrtarit jashtë institucionit.

Pastaj, Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare nr. DLK-02-01/1310/20, ka kërkuar informacione nga kompania “Eida Patroni”, lidhur me angazhimin e z. Mazreku në këtë kompani, me ç’ rast e njëjta ka konfirmuar se z. Mazreku asnjëherë nuk ka pasur dhe nuk ka marrëdhënie pune me atë kompani.

Fakti se z. Mazreku nuk ka pasur dhe nuk ka marrëdhënie pune me kompaninë “Eida Patroni”, është vërtetuar edhe me informacionin e pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila përmes shkresës nr. 04-06-2019, na ka njoftuar se në bazë të sistemit informativ nga viti 2015 e deri në muajin Maj 2020, z. Mazreku nuk figuron në listën e pagave si punëtor në atë kompani.

Edhe në shkresën zyrtare që z. Mazreku, e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit me nr. DPKI-06-1588/20, me përgjegjësi të plotë ka deklaruar se ai nuk është i punësuar në kompaninë “Eida Patroni”.

Agjencia kundër Korrupsionit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se nuk janë të bazuara dyshimet për konflikt të interesit, për faktin që z. Mazreku nuk ka marrëdhënie pune në kompaninë e lartë cekur dhe se pretendimet e ngritura për konflikt të mundshëm të interesit në këtë rast janë të pasakta.

Andaj, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

